



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.338, datë 13.11.2023

PËR

**“VERIFIKIMIN E KANDIDATËVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE
TË KANDIDIMIT PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT NËPËRMJET
LËVIZJES PARALELE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.319, DATË
20.10.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 9 dhe 15 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për 2 (dy) vende vakante në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për kandidatët:
 - a. Leonard Suçi
 - b. Redona Ndoni
2. Relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Ledina Riza